



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Sokol Haliti, Kryetar i Komunës së Vitisë Naim Pira, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë	
Kopje	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes: <i>pei</i>	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së <i>BF. Todosijevic</i> Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së <i>Rozafa Ukimeraj</i>	
Nga:	Xhevat Tafa, U.D. Drejtor i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	Datë: 05/10/2018 Nr. 020/1102
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit të komunës së Vitisë	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e QRK-së Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi Nr. 01-110/05-102 për inicimin e procedurës për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale - parkingjet në qytetin e Vitisë
I miratuar më datë më datë: 28.09.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 01.10.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.**

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendimi Nr. 01-110/05-102 për iniciimin e procedurës për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale - parkingjet në qytetin e Vitisë	<p>Vendimi Nr. 01-110/05-102 për iniciimin e procedurës për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale - parkingjet në qytetin e Vitisë është në kundërshtim me Ligjin Nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, përkatësisht me nenin 7 pika 2 dhe 3 ku e specifikon se propozimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës duhet të identifikojë emërtimin e pronës, madhësinë e saj, të specifikojë arsyet, qëllimet dhe kohëzgjatjen si dhe formën në të cilën rekomandohet procesi për dhënien e pronës në shfrytëzim.</p> <p>Gjithashtu Kuvendi i Komunës merr vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës me shumicë të votave të anëtarëve të Kuvendit të Komunës</p>

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Sokol Haliti, gradonačelnik Opštine Vitina Naim Pira, predsedavajući Skupštine opštine Vitina
Kopija:	Jedinica za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinica za administraciju dokumenata u opštini
Preko:	24. Ivan Todosijević, ministar MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka u MALS-u
Od:	Xhevat Tafa, v.d. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS
Predmet:	Zahtev za reviziju akta opštine Vitina
Vrsta akta:	Odluka

Datum,
05.10.2018.
020-1102

Poštovani gradonačleniče,
Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine, na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku.

Odluka br. 01-110/05-102 za pokretanje postupka za davanje na korišćenje opštinske imovine - parkinzi u gradu Vitina
Usvojena dana, 28.09.2018. godine,
Predložena za razmatranje u MALS-u, dana, 01.10.2018. godine,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je akt u saglasnosti za odredbam zakonodavstva na snazi.
Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je isti u suprotnosti zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi.

U nastavku ćete pronaći neusklađenost predloženog akta opštine za razmatranje zakonitosti kao u nastavku:

Br.	Formulisane u aktu opštine	Zakonska odredba sa kojom jje akt opštine u suprotnosti.
1.	Odluka br. 01-110/05-102 za pokretanje postupka za davanje na korišćenje opštinske imovine - parkinzi u gradu Vitina	Odluka br. 01-110/05-102 za pokretanje postupka za davanje na korišćenje opštinske imovine - parkinzi u gradu Vitina je u suprotnosti sa Zakonom br. 04/L-144 o davanju na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine, odnosno sa članom 7, tačka 2 i 3 gde se specifikuje da predlog za davanje na korišćenje nepokretne imovine opštine treba da identifikuje imenovanje imovine, njenu veličinu, da obrazloži razloge, ciljeve i vreme trajanja kao i oblik su kojem se se preporučuje proces za davanje imovine za korišćenje. Takođe, skupština opštine donosi preliminarnu odluku za davanje na korišćenje pokretne opštinske imovine sa većinom glasova članova skupštine opštine.

Na osnovu gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouprave, od skupštine opštine i gradonačelnika traži da preduzimaju konkretne mere kako bi akt opštine uskladili sa zakonskim odredbama na snazi, unutar predviđenog vremenskog roka od 30 dana od dana primanja zahteva za razmetranje akta.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštini za dalja objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

28-09-2018

01-110/05-1002



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Vitina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d), neni 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në bazë të nenit 5 dhe 7 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Ligjit Nr.04/L-144, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012), Rregullores QRK nr. 23/2013 për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës si dhe neni 35, paragrafi 35.2, shkronja i) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, pas shqyrtimit të propozim vendimit të Kryetarit të Komunës me Nr. të Protokollit 02-035/02-950, të datës 14.09.2018, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seance e mbajtur më datën 27.09.2018, merr këtë:

VENDIM

Për iniciimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale –parkingjet në qytetin e Vitisë

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë i jep pëlqimin për fillimin e procedurave për shpalljen e ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër pronën komunale – parkingjet në qytetin e Vitisë, të cilat shtrihen në parcelën nr.2592-1 dhe parcelën nr. 3625-1 në zonën kadastrale në Vitë.

Neni 2

Obligohet Komisioni komunal për vlerësimin e ofertave, që në pajtim me Ligjin për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144, të datës 22.11.2012 dhe Rregulloren QRK-së me nr.23/2013 për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale të kryhen procedurat e ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër.

Neni 3

Obligohet Komisioni për vlerësimin e ofertave, duke u bazuar në Rregulloren komunale për taksat, ngarkesat dhe gjobat, të përcaktoj çmimin fillestar të dhënies në shfrytëzim të pronës komunale.

Neni 4

Mënyra e shfrytëzimit dhe menaxhimit të lokacionit të përcaktuar në këtë vendim rregullohet sipas procedurave të parapara ligjore.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës përmes organeve kompetente.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në kuptim të nenit 81, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8 të Rregullores (QRK) Nr.01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, neni 16 i Rregullores (MAPL) Nr. 01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës dhe pas publikimit në Web faqen e Komunës së Vitisë.

1. Drejtorisë për Kadastër,
2. Drejtorisë për Shërbime Publike,
3. Shërbimit të Kuvendit, dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI
Naim Përa

